



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	23-09-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDYSHCK	5628/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.700/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.700/2022 të datës 12.08.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit/Ministrit të Drejtësisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.700/2022 e datës 12.08.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministria e Drejtësisë, më datë 06.06.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Avokat Shtetrorë-5 pozita), ku afati për aplikim rrjedh nga data 21.06.2022-28.06.2022.

Ankuesi më datë 12.08.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4678/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet që ky konkurs është shpall me shkelje ligjore dhe diskriminuese dhe se në momentin që ka provuar të aplikoj sistemi online nuk ka funksionuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.08.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë Drejtësisë. Ndërsa Këshilli më datë 30.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot: 4678/2022 të datës 12.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.08.2022; Përgjigjen në aneksë e datës 30.08.2022; Kërkesë për aprovimin e fillimit të procedurës e datës 18.05.2022; Kërkesë për fillimin e rekrutimit e datës 18.05.2022; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Vendimin me Nr. 08/22 i datës 23.05.2022 për miratimin e fillimin të procedurës për pozitën Avokat Shtetëror; Konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për Avokat Shtetëror; Emailin e datës 03.06.2022 nga \_\_\_\_\_ për Njoftimin për përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak datë 19.07.2022; Emailin e datës 28.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 27.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 26.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 07.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 06.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ Kërkesë për informata e datës 22.09.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe përgjigjen e datës 22.09.2022.*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi, se ankesë e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon në momentin që ka provuar të aplikoj sistemi online nuk ka funksionuar dhe nga ministria më kanë thënë që nuk mund të aplikohet nga shtëpia pasi që kam qenë në pushim mjekësor, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se as ankuesi po ashtu as Ministria e Drejtësisë nuk ka dërguar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte që ankuesi ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Avokat Shtetëror, po ashtu ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë shkresë që të ketë paraqitur tek personat përgjegjës të ministrisë shqetësimin e tij që nuk po mund të aplikoj në këtë pozitë, si rrjedhojë meqenëse ankuesi nuk ka dëshmi që ka aplikuar në këtë pozitë, si dhe për t'a shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimin e ankuesit kemi kërkuar informata nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa më datë 22.09.2022 kemi pranuar informatë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme se: *"Lidhur me kërkesën tuaj, ju njoftoj se, Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) përbëhet nga: aplikacioni kryesor për menaxhim të burimeve njerëzore, aplikacioni për realizimin e testimit me shkrim në formë elektronike dhe aplikacioni për publikim dhe aplikim në procedurat e rekrutimit për nëpunës civil. Për dallim prej dy moduleve të para të sistemit, aplikacioni/moduli për publikim dhe aplikim në procedurat e rekrutimit për nëpunës civil, përkatësisht ueb faqja <https://konkursi.rks-gov.net/> është e publikuar në internet dhe qasja në te është e mundur pavarësisht se ku gjendeni, thjesht njafton të keni internet dhe llogari".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 125 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), rrjedhimisht ankuesi ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk e ka parashtruar kundër një akti administrativ apo ndonjë mosveprimi të institucionit, për*



shkak që nuk ka parashtruar asnjë kërkesë që institucioni ka qenë i obliguar t'i përgjigjet, për me tepër meqenëse ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë që ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Avokat Shtetëror përmes portali për rekrutimit elektronik sipas pikën 11 të konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Avokat Shtetëror, atëherë sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, të njëjtit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës apo të njëjti nuk i është mohuar asnjë e drejtë në këtë procedurë, rrjedhimisht pala ankuese nuk ka legjitimitet për parashtrimin e ankesës dhe për pretendimet kundër një procedure që nuk ka qenë pjesë e saj siç parashihet me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."* si dhe ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të këtij ligji.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.700/2022

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.